



**STUDIME  
MUZEOLOGJIKE**



**Muzeu Historik Kombëtar**

**MUZEU HISTORIK KOMBËTAR**

**STUDIME  
MUZEOLOGJIKE**

**Nr. 5**

**Tiranë, 2015**

Muzeut Historik Kombëtar

© Të gjitha të drejtat janë të Muzeut Historik Kombëtar

Redaksia:

Ph.D.C. Melsi Labi, Ph.D.C. Dorian Koçi, Prof.Dr. Pëllumb Xhufi, Prof.Dr. Luan Përzhita, Prof.Dr. Persida Asllani, Gjet Ndoj.

Arti grafik: Ilir Gusho, Adi Shehu

Tel/Fax +355 42 28 389

Tel: +355 42 23 446

Në ballinë: Stema e Principatës së Arbrit

Në kapakun e pasëm: Mbishkrimi i Ndërfandës

## PËRMBAJTJA

<b>Ph.D.C. Melsi Labi</b> Zbulimi i relikeve të Gjon Vladimirit në Muzeun Historik Kombëtar .....	5
<b>Ph.D.C. Dorian Koçi</b> Toponimia dhe simbolet kulturore në Këngët e Milosaos .....	25
<b>Prof.Dr. Luan Përzhita</b> Një objekt unikal i ikonografisë paleokristiane nga provinca e Dardanisë ..	36
<b>Etleva Demollari</b> Gratë e huaja në trashëgimi: pioniere të kulturës pa kufi .....	45
<b>Andrea Llukani</b> Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik kombëtar .....	52
<b>Ledio Xhoxhi</b> Muzeu dhe komuniteti: Një reflektim mbi teoritë dhe praktikat muzeore ..	60
<b>Erilda Selaj</b> Ndërhyrjet konservuese në kutinë e lipsaneve të Shën Gjon Vladimirit ...	71
<b>Spiro Nika</b> Luadhi i Çajupit me potencialet arkeologjiko monumentale të tij .....	80
<b>Sabina Veseli</b> Një figurinë Jupiteri prej bronzi në Muzeun Historik Kombëtar .....	88




## IKONAT E MIHAL ANAGNOSTIT NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

Veprimtaria e Mihal Anagnostit dhe e pasardhësve të tij shtrihet kryesisht në gjysmën e parë të shek. XIX. Mihal dhe Dhimitër Anagnosti pjesën më të madhe të punës së tyre, ia dedikuan pikturimit të ikonave të kishës së Shën Mërisë në Elbasan (Fig 1). Ikonat datojnë më 1828. Në vitin 1830 ata kanë pikturuar dy ikona në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë (Fig 2).



(Fig. 1)



(Fig. 2)


Ikonën e madhe të Krishtit Pandokrator dhe atë të Shën Mërisë me Krishtin në ikonostasin e kishës<sup>1</sup> si dhe dy ikona në kishën e manastirit të Apolonisë.

<sup>1</sup>-Kisha e Ungjillëzimit është përruar më 1 shtator të vitit 1873. Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që gjendet në faqen e murit lindor të kishës: +Ωκοδομήθη ο ιερος ναος ου / τος επονοματι της Υπεραγ / ιας Θε(εοτό)κου του Ευαγγελισμού ων τα / ονοματα μνησθειη ο Θεος εν / τη βασιλεια αυτου. Εν ετει 1873. “U ndërtua ky tempull i hirshëm me emrin e së mbishenjtës Hyjlindëses së Ungjillëzimit, emrat e të cilëve (ktitor e ndërtues) i kujtoftë perëndia, në mbretëri të tij, në vitin 1873”; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.65, faqe 74; Dhimitër Beduli, *Kodiku i Kishës së Shën Prokopit të Tiranës (1818-1922)*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997, faqe 54.




Njera prej tyre, ikona e Joan Pagëzorit (Fig 3) gjendet në pavijonin e ikonave të Muzeut Historik Kombëtar e identifikuar me numër inventari 3690. Mihal dhe Dhimitër Anagnosti kanë punuar gjithashtu në Samarinë dhe Kalabaka të Greqisë, në Kërçovë dhe në manastirin Treskavets.<sup>2</sup> Në manastirin e Gjon Pararendësit në Dibër, Mihali dhe Dhimitri kanë pikturuar ikonat e mëdha të ikonostasit, ikonat e festave dhe brezin me ikonat e shenjtoreve. Gjithashtu pikturuan trapezarinë dhe kupolën e kishës.<sup>3</sup>

Muzeu Historik Kombëtar ka të ekspozuara disa ikona të Mihal Anagnostit, që e kanë prejardhjen nga kisha e Shën Mërisë në Elbasan. Ikona e madhe e Krishtit që gjendej në ikonostasin e kishës është pikturuar prej Mihal Anagnostit nga Samarina: Διά χειρός Μιχαήλ Αναγνώστου τού εκ Σαμαρίνης “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina”<sup>4</sup> (Fig 4). Ky



(Fig 3)



(Fig 4)

mbishkrim vërteton se Mihal Anagnosti vinte nga Samarina, një fshat vllahësh

<sup>2</sup>-Drakopoulou, *The Itineraries of the Orthodox Painters in the Eighteenth Century*, nos 64-65.

<sup>3</sup>-Dimitar Cornakov, *Macedonian monasteries, Malice Makedonska*, Shkup, 1996 faqe 56.

<sup>4</sup>-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Neraida, Tiranë 2010, faqe 16; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.79, faqe 77.



në Grebena. Mihal Anagnosti e trashëgoi traditën e pikturimit të ikonave tek djali i tij, Dhimitri. Ata kanë pikturuar së bashku ikonën e Krishtit dhe atë të Shën Mërisë në ikonostasin e kishës së Ungjillëzimit në Tiranë. Mbi ikonën e madhe të Krishtit gjendet mbishkrimi: Διά χειρός ταπεινων ζωγραφων Μιχαηλ / καί Δημητριου τού είού αυτού α ω λ (=1830). “Me dorën e piktorëve të përvuajtur Mihalit dhe Dhimitrit, birit të tij, 1830”.<sup>5</sup> Ikonat e mëdha të ikonostasit të kishës së Joan Pagëzorit në Dibër të Madhe janë pikturuar nga “Dhimitri i Mihalit nga Samarina”. Pra djali i tij quhej Dhimitër dhe pasi përqafoi jetën monakale mori emrin Daniel.<sup>6</sup>

Në pavijonin e ikonave të Muzeut Historik Kombëtar gjenden disa ikona të pikturuara nga Mihal Anagnosti si edhe Dyert Mbretërore të kishës së Shën Mërisë në Elbasan. Tematika e ikonave është e ndryshme: 1-Kemi ikona shenjtoresh: “Tre Jerarkët”, “Shën Julita dhe Shën Marena”, “Ungjillorët Mateu, Marku e Luka”, “Shën Harallambi dhe Shën Trifoni”, “Shën Athanasi i Madh, Kirili i Aleksandrisë dhe Eftimi i Madh”, “Shën Gjergji”, “Ikona e gjithë shenjtoreve” etj. 2-Skena nga jeta e Krishtit: “Rrethprerja e Krishtit”, “Hyrja në Jeruzalem”, “E diela e të verbërit” etj.

Kisha e Shën Marisë që gjendet në lagjen Kala të qytetit të Elbasanit është bazilikë trinefëshe dhe është ndërtuar në vitin 1818, por pasi është djegur u rindërtua në vitin 1833.<sup>7</sup> Për ndërtimin e kishës punuan vllahët nga

<sup>5</sup>-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.50, faqe 68.

<sup>6</sup>-Dimitar Cornakov, *Macedonian monasteries, Malice Makedonska*, Shkup, 1996 faqe 57.

<sup>7</sup>-Mbi një pllakë guri të vendosur në apsidë jashtë kishës shkruhet: “U ngrit ky tempull hyjnor i nderuar me emrin e Hyjlindëses në vitin prej Krishtit 1833, duke filluar më 21 janar e përfundoi më 20 maj. Kjo ngjau në ditët kur ishte peshkop i gjithhirshmi, muzikanti i shumëditur, shenjt i Durrësit, zoti Krisanth dhe në kohën e kujdestarisë së zotit Kostë Nasit, ku nxitës e shkaktar u bë doktori i shkëlqyeshëm zoti.....nga Negadha. Dhe me kontributin dhe shpenzimet e të gjithë të krishterëve të paharruar, që gjenden këtu, të cilët zoti ynë i kujtoftë në mbretëri të qiejve. Amin, 1833 maj 20. Janar 20, 1833”. Teologu Theofan Popa sqaron se mitropoliti që përmendet në mbishkrim ka qenë Krisanth Karmanlisi (1770-1846), i cili ka shkruar metodën e re të paraqitjes së shenjave muzikore duke emërtuar tingujt e muzikës bizantine: Pa, Vu, Ga, Dhi, Qe, Zo, Ni. Metoda e re u miratua nga Patriarkana Ekumenike në vitin 1814; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.52, faqe 69-70.



lagja e Shën Kollit.<sup>8</sup> Ikonostasi i kishës është punuar prej mjeshtër Filipit nga Reka e Dibrës.<sup>9</sup> Dyert mbretërore të kishës së Shën Mërisë janë



(Fig 5)



(Fig 6)

<sup>8</sup>-Këtë e vërteton mbishkrimi jashtë apsidës së kishës: + Ιστέρον μέν το οτι πρωτομα / στορες μεν οι κτισαντες τον θει / ον και ιερον ουτον ναόν υπή / χον ο Στέφο Βλλάσσοσ, ό Μή / τρος Ζάπος ό Γεωργι(ος) Μπατά / νοσ και ό Ιώαννης Πρέντου / ή δέ πληρωμή του έργου αυ / των γέγονε τάλαντα ξ (=60). “Duhet ditur, pra se kryemjeshtrit që ndërtuan këtë tempull të hirshëm kanë qenë Stefo, Vlashi, Mitro, Zhapa, Gjergj Batani dhe Gjon Prendi, kurse pagesa e punës së tyre ka qenë 60 tallanta”; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.53, faqe 70.

<sup>9</sup>-Këtë fakt e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi derën e bukur. Τό παρόν τέμ(π)λον έγλίφθη, και ετορνεύθη τό 1859, έτος επί / επί άρχιερ(α)τειας ιωαννικίου έπιτροπ(ε)ιασ δέ Δημήτ(ριου), άνδρεού / καζαν(τ)ζή και κωνσταντινου, Αντών(ιου), έχρυσώθη δέ το 1868 έν ήμέραισ / άρχιερατεύοντος του Πανιερώτατου άγίου δυρραχίου Κ.Κ. ΒΗΣΣΑΡΙωνος έπιτροπευοντων των Κ.Κ.Χ. κωστανδίν(ου) παπά ί(ω)άννου, Ιωάννου Τζούφκα και Κωνστ(αντίνου) / Συμεώνος, τή εύσεβάστω προθυμία πάντων των φιλοχρίστων χριστιανών καστρου, / χείρα Ιωσίφ 1868 κατά μήνα δεκέμβριον ιμερας 21. “Ky tempull (ikonostas) u gdhend dhe u tornua në vitin 1859, në kohën e peshkopatit të Joaniqit dhe kur ishte epitrop Dhimitër Andre Kazanxhiu dhe Kostandin Andoni. U varakos më 1868 në vitet e peshkopatit të gjithirshmit, shenjtit të Durrësit Z.Z. Visarion, dhe kur ishin epitropë Z.Z. Kostandin Papajani, Jan Xhufka dhe Kostandin Simoni, me dëshirën e devotshme të të gjithë të krishterëve, krishtdashës të Kalasë. Dora e Josifit 1868 në muajin dhjetor, ditë 21”; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.63, faqe 73.



gdhendur nga mjeshtër Filipi dhe janë pikturuar nga ikonografi Mihal Anagnosti. Në fondet e Muzeut Historik Kombëtar kemi mundur të identifikojmë edhe dyert anësore të kishës së Shën Mërisë, Kryeengjëllin Gabriel me numër inventari 5937 (Fig 5) dhe Kryeengjëllin Mihail me numër inventari 5922 (Fig 6).

Krijimtaria e Anagnostëve shquhet për kompozimet me veshje të larmishme dhe të zbukuruara me motive floreale e gjeometrike. Në sfond ata përdorin peizazhe arkitektonike. Ikonat e tyre dallohen nga një plastikë e pasur si edhe nga një pasuri koloristike dhe ornamentale.<sup>10</sup> Ikonat e tyre janë të pasura me detaje të shumta floreale dhe zoomorfe. Veshjet e përdorura për shenjtorët e tij, janë të pasura me detaje plot ngjyrë dhe formë. Stili i tyre ndërthurret ndërmjet pikturës dhe ikonografisë, sepse nëpër ikona vërrejmë shumë detaje piktoreske. Sapo përballesh me këto vepra



(Fig 7)



(Fig 8)

të bien menjëherë në sy tekstilet moderne që janë përdorur. Ngjyrat e përdorura në ikona janë të gjalla. Dominojnë e kuqja, okra dhe bluja. Figurat e shenjtorëve që janë paraqitur në këto ikona, janë më ekspresive. Kulmi i pjekurisë artistike është shprehur në ikonat e Shën Gjergjit, (Fig 7) Shën Mërisë me Krishtin (Fig 8) dhe Krishti Pandokrator. Në këto vepra stili i tij

<sup>10</sup>-Kristofor Naslazi, *Influenca e shkollës ikonografike të Korçës te disa piktorë të shek. 19-të*, Monumentet 2002, faqe 108.



është përsosur si në pasurimin me detaje të tekstileve edhe me format e shprehura anatomike. Kjo përsosmëri artistike, përkon me vitin 1828, që vëmë re në disa prej ikonave. Ikonat e pikturuara nga Mihal dhe Dhimitër Anagnosti i përkasin artit pasbizantin. Me Mihal dhe Dhimitër Anagnostin mbyllet epoka e artit pasbizantin në Shqipëri.

Njëri nga pasardhësit e tyre, Nikolla Anagnosti ka pikturuar në Kërçovë, Prilep dhe në Manastir, duke qenë ikonografi më produktiv i shek. XIX në Maqedoni. Në vitin 1849, biri i Mihalit, Nikolla ka pikturuar ikonën e Shën Kostandinit dhe Elenës në ikonostasin e kishës Lindja e Shën Mërisë në Elbasan. Këtë e vërteton mbishkrimi që gjendet mbi ikonë: Χείρ Νικολάου υού Μηχαήλ / Ζωγράφου έκ Κρουσιόβου 1849. “Dora e Nikollës, birit të Mihalit Zografit, nga Krusheva, 1849”.<sup>11</sup> Tjetër pasardhës është Diço Zografi,<sup>12</sup> i cili ka pikturuar rreth dy mijë ikona në Maqedoni, Bullgari dhe në Serbi. Diço e mësoi artin e ikonografisë prej mësuesve të tij Mihal dhe Dhimitër Anagnostit gjatë kohës që kanë punuar së bashku në manastirin e Bigorskit.<sup>13</sup> Ikonografi i talentuar Diço Zografi në vitin 1853 ka pikturuar ikonat e kishës së Shën Gjergjit në Vërnice të Gollobordës.<sup>14</sup> Ky fakt vërtetohet nga mbishkrimi që ka lënë në ikonën e Shën Mërisë: “Me dorën e Diço Zografit, nga katundi Tresance, 1853, muaji dhjetor 4”. Mbishkrimi është shkruar me alfabetin cirilik, ndërsa për datën ka përdorur greqishten bizantine.<sup>15</sup>

<sup>11</sup>-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr.58, faqe 72; “Të parët që kanë themeluar Krushevën kanë qenë shqiptarët, më pas kanë ardhur vllahët dhe më pas shqetë”; *Krusheva nga një krushovar*, Kalendari Kombiar, Sofje 1904, faqe 58.


<sup>12</sup>-Diço Zografi ka pasur dy djem Abrahamin dhe Spiridhonin, të cilëve u mësoi artin e ikonografisë. Djali i madh, Abrahami ka pikturuar shumë kisha, por nuk e kishte talentin e të atit, ndërsa Spiridhoni vdiq herët. E veçanta e Diço Zografit është sepse ai në çdo ikonë ka lënë nënshkrimin e tij. Përkushtimet e donatorëve të ikonave ai i shkruante sllavisht ose në greqishten bizantine, sipas porosive. Diço Zografi ka përkthyer një manual ikonografie të shkruar nga vëllezërit Zografi. Në të, Diço ka lënë shënimet e tij. Ai ka qenë ikonografi më i shquar i kohës në Maqedoni. Porositësit prisnin me vite të tëra për të pasur një ikonë të pikturuar prej Diço Zografit. Tematika e ikonave të pikturuara prej tij është e larmishme. Aktivitetin kryesor e ka zhvilluar në fshatin Tresonik, ku gjendej atelieja e tij.

<sup>13</sup>-Sasho Cvetkovski, *The icons of Dico Zograf from the churches in Deber and Mala Reka*, Struga 2013, page 299-310.

<sup>14</sup>-Kristofor Beduli, *Ortodoksët e Gollobordës*, Neraida, Tiranë, 2008, faqe 20.

<sup>15</sup>-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 59, faqe 71-72.





(Fig 9)

Sipas programit për kartelizimin dhe studimin shkencor të të gjithë materialit që gjendet në fondin e Muzeut Historik Kombëtar, gjatë hulumtimit u gjetën disa ikona, të cilat mendohet se janë pikturuar nga Diço Zografi. Ikona e Shën Kollit me numër inventari 5947, ikona e Shën Athanasit me numër inventari 5914 dhe ikona Fjetja e Hyjlindëses me numër inventari 5978. Këto ikona i përkasin kishës së Shën Kollit në Elbasan. Në fundin e ikonës së Shën Kollit, (Fig 9) emrin e të cilit mban kisha, Diço Zografi ka lënë mbishkrimin (Fig 10) dygjuhësh në

g r e q i s h t e n  
bizantine dhe në  
sllavishte: διά  
χειρός δήτζου  
ζωγράφου έκ  
ἐπαρχίας  
Δεβρων, 1855. “Me dorën e Diço Zografit nga zona e Dhevron”, 1855.



(Fig 10)

## Bibliografi

1-Drakopoulou, *The Itineraries of the Orthodox Painters in the Eighteenth Century*, nos 64-65.

2-Dimitar Cornakov, *Macedonian monasteries, Malice Makedonska*, Shkup, 1996 faqe 56.

3-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Neraida, Tiranë 2010, faqe 16; Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1998, nr.79, faqe 77.

4-Dhimitër Beduli, *Kodiku i Kishës së Shën Prokopit të Tiranës (1818-1922)*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997, faqe 54.

5-Kristofor Naslazi, *Influenca e shkollës ikonografike të Korçës te*

*disa piktorë të shek. 19-të*, Monumentet 2002, faqe 108.

6-Kristofor Beduli, *Ortodoksët e Gollobordës*, Neraida, Tiranë, 2008, faqe 20.

7-Krusheva nga një krushovar, *Kalendari Kombiar*, Sofje 1904, faqe 58.

8-Sasho Cvetkovski, *The icons of Dico Zograf from the churches in Deber and Mala Reka*, Struga 2013, page 299-310.

9-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 59, faqe 71-72.